



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 126/4 prot.

Peshkopi, më 16.06.2022

VENDIM

Nr. 10 Datë 16.06.2022

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR EKSPERTËT E JASHTËM”**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 77/ç, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022”, neni 5/ç të ligjit nr. 10405 datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Ligjit nr. 112/2014 “Për dekorata, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në VKM nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtetasve të pensioneve të posaçme shtetërore”, ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorëve të Atdheut”, Vendimi i Këshillit të Qarkut Dibër nr.16, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2022”, Rregullores për organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Dibër nr.115, datë 18.11.2015, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë e ulet dhe të mesme drejtuese”, VKM-në nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjes paralele, periudhën e provës dhe emërimit në kategorinë ekzekutive”, Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Këshillit të Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 16.06.2022 pasi mori në shqyrtim projekt vendimin e Kryesisë nr. 10, datë 16.06.2022 “Për miratimin e masës së shpërblimit për ekspertët e jashtëm” me 9 (nëntë) vota pro,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërblimit në masën **10 000 (dhjetë mijë)** lekë për ekspertët e jashtëm që do të jenë pjesë e komisioneve të prokurimeve publike (njësi prokurimi, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i marrjes në dorëzim).

2. Miratimin e shpërblimit në masën **10 000 (dhjetë mijë)** lekë për ekspertët e jashtëm që do të jenë pjesë e komisioneve të pranimit në shërbimin civil dhe **5 000 (pesë mijë)** lekë për ekspertët e komisioneve për ngritjen në detyrë në shërbimin civil.
3. Miratimin e shpërblimit në masën **7 000 (shtatë mijë)** lekë për ekspertët e jashtëm që do të jenë pjesë e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit dhe propozimet për pension të posaçëm dhe dëshmor të atdheut.
4. Miratimin e shpërblimit në masën **7 000 (shtatë mijë)** lekë për personalitetet e arsimit që janë anëtarë të Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitarë. Pika 2 e Vendimit të Këshillit të Qarkut Dibër nr.8 datë 28.06.2018 shfuqizohet.
5. Shpenzimet për këto shpërblime do të mbulohen nga buxheti i KQ, shpenzimet operative llogaria 602, nënlllogaria 6029005 "Honorare"
6. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe i Projekteve dhe Sektori i Financës.
7. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
9. U shpall me dt 16.06.2022

**KRYETAR**

**Valentina Halifi**

